

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

SHABAN SINANI

DE RADA DHE MILLOSAU RRETH VARIANTEVE TË EMRIT TË AUTORIT DHE TË VEPRËS

I.

Për emërtimet e përveçme në veprën e De Radës ekziston një diskutim relativisht i hershëm. Më së shpeshti vëmendja është përqendruar tek pyetja se cila është *Arbëria historike* që i përgjigjet *Arbërisë poetike* të De Radës, sa janë ato *izotopike* dhe sa *heterotopike*; a ka një mbivendosje të këtyre dy *Arbërive* ndaj njëra-tjetrës; çfarë mori prej botës së vërtetë arbërore të fundit të Mesjetës, çfarë mori prej mjedisit arbëresh të vendlindjes dhe çfarë u ktheu atyre përmes veprave letrare. *Scutari në Himarë apo në Shkodër*, kjo do të ishte pyetja në të cilën shprehet thelbi i këtij diskutimi tradicional¹, që hera-herës shpërfill si pavarësinë e letërsisë nga realiteti parësor, ashtu dhe formimin e vetë De Radës si një poet i dijshtëm, që e shkroi veprën e tij me vetëdijen e rreptë që nuk duhej të kishte asgjë rastësore në të. Në anën tjetër, nuk mund të lihet anash fakti i rëndësishëm, që De Rada është i vetmi poet në historinë e letërsisë shqipe që me autoritetin e vet ka ndikuar deri në rindërtimin e toponimisë së viseve arbëreshe, duke imponuar, bie fjala, në vend të emërimit të vjetër historik *Piana dei Greci* emërtimin e ri *Hora e Arbëreshëve*.

Siç vëren me të drejtë Matteo Mandalà, *rëndësia e zgjedhjes së emrit të personazhit në veprën e De Radës është vendimtare*². Mënyra si identifikohet një mjedis apo një karakter letrar ka diçka të ngjashme me sakramentin e pagëzimit. Nuk mund të jetë e rastit që *njena nga ato* në skicën e njohur të Migjenit mban emrin femëror të njërit prej katër ungjilltarëve, *Shën Lukës*; që narratori i romanit *Hasta le Vista* quhet Gori (një shmangie elegante prej formës *Guri*, trajta shqip e vetë emrit të autorit, Petro Marko); nuk është e rastit që emri Ana dhe variantet e tij: Diana, Zana, Suzana, për më tepër emri i Besnik Strugës në romanin *Dimri i vetmisë së madhe*, të jetë rastësor; nuk mund të jetë e rastit që një nga format e emrit Radhavan tek vepra e De Radës është dypjesësh, *Radha-Van* (tek stolisenej *Rradha-Vân*) dhe përputhet me mbiemrin e vetë poetit³.

¹ Shih, për shembull, M. Zeqo, *De Rada: rishpikja e Arbërisë - sprovë kritike për një lexim të ri*, bot. Erik, Tiranë 2014, f. 228.

² M. Mandalà, *Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës (1822-1837)*, këshilluar në dorëshkrim me pëlqimin e autorit.

³ J. De Rada, *Rapsoditë shqiptare*, në *Vepra letrare*, vëll. V, përgatiti për botim Fiorella de Rosa, Tiranë 2014, f. 326: *Shkepti dielli ngā bōret / e m'i rā një rremb ndē bāllt / të birit të Dukes ghōres / tek stolisenej Rradha-Vân / t'aredhur kâ të luftuarit / stolisnej e i vëj kurōr*.



**Jeronim de Rada në vitet e fundme të jetës
(Arkivi i Dhimitër S. Shuteriqit).**

Për emërtimet e përveçme në veprën e De Radës diskutimi përgjithësisht ka pasur *karakter lokalizues*, në formën e një përpjekjeje për t'u gjetur atyre një simetri të sigurt. Sa i takon emërtimit të karaktereve, studimet kanë qenë më të kufizuara⁴. I pari që pati tërhequr vëmendjen për *një emër të çuditshëm* (*A strange Name*) në poemën *Këngët e Millosaut* të De Radës ishte Arshi Pipa⁵, i cili nuk kishte dyshim për prejardhjen sllave të emrit të personazhit.

⁴ Shaban Sinani, *Botë arbërore veriore në letërsinë arbëreshe: rasti i patronimeve*, në *Midis dy Rilindjesh*, bot. i Universiteti i Elbasanit, Tiranë 2010, f. 156-170.

⁵ Arshi Pipa, *Hieronymus De Rada - Jeronim De Rada*, botimet *Princi*, Tiranë 2013, f. 50-57.

Pipa merr në analizë arsyet e mundshme që sipas tij do të kenë shtyrë De Radën të zgjedhë një emër sllav. Pipa ishte aq i bindur për këtë, sa besonte se emrin e alter egos së vet De Rada ta ketë gjetur përmes njohjeve të tij të drejtpërdrejta me ndonjë sllav me të njëjtin emër gjatë qëndrimit në Napoli: Në dritën e dëshmimeve të tilla, mund të themi se De Rada nuk e ka shpikur emrin dhe rangun e “alter ego-s” së vet. Dhe, megjë ky emër nuk del në traditat dhe folklorin arbëresh, burimi mund të jetë i natyrës letrare. Ka të ngjarë që poeti të ketë njohur ndonjë sllav në Napoli, i cili ia ka shpjeguar kuptimin e emrit. Sidoqoftë, atë emër ashtu e ka zgjedhur⁶.

Nuk është për t'u përjashtuar që De Rada të ketë njohur miq me mbiemra pravosllavë jo vetëm në Napoli, por dhe në katundet arbëreshe. Keqkuptimi i A. Pipës lidhet me ngatërrimin e besimit ortodoks pravosllav me etnicitetin sllav. Është i njëjti konfondim që e ka çuar historianin Oliver Jens Schmitt në përfundimin e gabuar për etnicitetin e familjes së Kastriotëve, duke e marrë besimin pravosllav të tyre (që shfaqet qartazi në emrat e përveçëm *Stanish*, *Reposh*, *Voisavë*) për etnicitetin sllav. *Milosh Kopiliq* quhet heroi i epit të betejës së Fushë-Kosovës, që ishte shqiptar e jo serb, siç gënjen historia⁷. Vetë mbiemri i Darenjve përdorej paralelisht si prej shqiptarëve, ashtu dhe prej sllavëve⁸. Emri *Milosao* është dhe sot me përdorim të gjerë tek serbët. *Milosao Jelić* quhej, ndër të tjerë, gazetari serb që pati intervistuar luftëtarin dibran Elez Isufi në vitin 1924⁹. Në punë të emrave të përveçëm De Rada nuk kishte pse të ndikohej prej njohjeve me miq sllavë, sepse këta emra i gjente tek arbëreshët vetë. Në një shenjim përshëndetës që De Rada e botoi në *Fiamuri Arbërit* më 30 tetor 1883 (p. VII) thuhet: *Stanislav Markjanoi nka Shën Sofia stamparti Anapulj, ku ka zotëri te Nikoqirjata e kishvet, një livër që shtie dritë të re tek ekjena së Pëlasjë (Plakjë), u thanë në mot ata që edhe sot janë e thuhën t'Arbëresh*.

Në veprën e De Radës mund të grupohen së paku pesë kategori emërtimeve të personazheve, pa emrat historikë me burim turko-osman. Në të njëjtën vepër bashkohen e ndërveprojnë karaktere me emra të formës ungjillore tradicionale arbërore, të formës ungjillore bizantine, të formës ungjillore pravosllave, emra me burim sanskrit dhe emra me burim klasik greko-latin:

⁶ A. Pipa, *Arshi Pipa, Jeronim De Rada*, vep. cit., f. 57.

⁷ A. di Lellio, *The Battle of Kosovo 1389: An Albanian Epic*, edit. I. B. Tauris, London 2009, p. 24-30.

⁸ M. Rešetar, *Le comunità serbocroate dell'Italia meridionale*, Campobasso 1997, f. 21-22.

⁹ Shih tek K. Dervishi, *Kujtimet dhe përshtypjet e Milosao Jelićit për Elez Isufin: artikull i gazetarit jugosllav i botuar në “Politika” të Beogradit*, në të përditshmen 55, 20 tetor 2004, f. 12-13.

Emërtime të formës ungjillore tradicionale arbërore	Emërtime të formës ungjillore bizantine	Emërtime të formës ungjillore pravosllave	Emërtime me burim sanskrit	Emërtime me burim klasik greko-latin
Lleshi Dukagjin (<i>ti me Lleshin Dukagjin</i>); Dedi Skura (<i>prapt dergjej Dedi Skura</i>); Gjin Bardhela (<i>Gjin Bardhëla, vellau im</i>); Nik Peta (<i>u shtu e mbudhi Nik Peta</i>); Gjika (<i>ajo Zonj e rëa e Gjikes</i>); Ndreu (<i>armonisi e zoti Ndrë</i>); Vera e Toçenjet (<i>e Vërën e Tocënjet</i>); Kont Urani (<i>kondi Urān</i>); Pjeter Shtrori (<i>malet e Pjeter Shtrorit</i>); Todhri - Todhra (<i>çoi Todhren e Xhinecevet, te qisha e Todhrit</i>).	Serafina Kollogre (<i>vjersh' i të bilës Kolloghrës; se ti, Shejte Kollogrë</i>); Agata (<i>zōnja Agat shtuara, thoi e rëa e Zōnjes Agat</i>); Prokseniti (<i>Araldo</i>); Irina; Olimpia (<i>Ollimpje ti motera ime</i>); Garentina (<i>Garendina, Jurendina: Garendin motera ime</i>); Garadini (<i>Garadini, murgu burr</i>).	Millo (<i>Millo: thuam po kush jë ti trim?</i>); Milo Shini (<i>Millo Shin kunati im</i>); Miloshini Millosau Bozdari Radha Vani (<i>tek stolisenej Radha-Vān</i>); Radhavani (<i>per gharën e Radhavanit, te vellān e Radhavān</i>); Stanisha, Staniza, Stanislā, Stanislao (<i>pestajna Staniza ulej</i>); Shklavuni (<i>ghapa dērn e Shklavunit</i>); Vladheni (<i>Vladēni</i>); Viovodë.	Vantisana Davadasa Urana Evoda ¹⁰ ; Vidhellajdha - Videlaide (?) Mosgravi (?) Adhina - Adine (?)	Annamaria Cominiate Odise Sofonisba Misistrati (<i>e bī-la e Misistratit</i>) Sibila (<i>me Sēbīlën, anamesa</i>).

¹⁰ Shih tek E. Çabej, *Në botën e arbëreshëve*, botimet MÇM Çabej, Tiranë 2014, f. 214.

Nëse do të ndërtohej një kronologji e shfaqjes për herë të parë të emrave që nuk kanë formën ungjillore as të krishterimit roman, as të krishterimit bizantin, do të duhej të ktheheshim disa vite para botimit të *Këngëve të Millosaut*, së paku në vitet 1833-1834, kur tek De Rada u shfaq për herë të parë zelli e pasioni i mbledhjes së këngëve popullore. Zuri të mbledhë këngë popullore arbëreshe, të cilat e mahnitën me bukurinë e tyre aq sa vendosi t'i imitojë në formë dhe përmbajtje. Botimi i *Këngëve Para-Millosaut* nën kujdesin sovran të Francesco Altimarit ka mundësuar hetimin e bashkëpërkimeve tekstore midis tyre dhe rapsodive arbëreshe¹¹, hetim që, siç ka shkruar Matteo Mandalà, na lejon të mbërrijmë deri tek *zanafilla e "shndërrimit" të emërvënësit më të famshëm të letërsisë romantike arbëreshe*¹². Në formën e shkurtër *Mill*, *Millo*, De Rada pagëzon një personazh në *Rapsodie Albanesi*¹³. Por më së hershmi De Rada pagëzon *Milo Shini*-n, apo *Miloshini*-n, emri i të cilit del për të parën herë në *Kangjeljin VIII*, titulluar *Anibecco e Miloscino*, që më pas De Rada do ta përfshijë në *Kangjeljin XI të pjesës së parë* po të *Rapsodive* (1866)¹⁴. Emri i *Millosaut* do të shfaqej më vonë, si një zhvillim derivues prej të njëjtit emërtim¹⁵.

Kërkimet që ka bërë së fundmi Matteo Mandalà për një kronologji të sigurt të shfaqjes së emërtimeve të përveçme jo prej botimeve, po prej dorëshkrimeve, që mbajnë data shumë më të hershme, e ndërlikojnë besueshmërinë e pohimit të Pipës, sipas të cilit kjo dukuri duhet të shpjegohet me ndikimin e njohjeve personale të poetit me ndonjë mik sllav. Për këtë arsye nuk do të ndalemi këtu tek format pravosllave të një shumice emrash të dy veprave binjake të De Radës, *Millosau* dhe *Serafina Topia*, si: *Bozdar* (rrjedhur prej *Božidar*, dhuratë prej Zotit), *Radhavān* e *Rodhovan* (nga sl. *Radovan*); pa përjashtuar dhe emrat historikë të familjes së Kastriotëve: *Stanish* e *Stanisha*, *Reposh*, *Voiza* e *Voisava*. Kalimthi po përmendim se shpjegimi i emrit të *Millosaut* prej sllavishtes *milŭ*, me kuptimin *i hijshëm*, *i sjellshëm*, *i mëshirshëm*, siç arsyeton A. Pipa, është më shumë një joshje artistike se një tentim dijetari, pasi fjala referenciale në këtë rast do të ishte *milly*, i dashur, njësoj si tek fjala *bogomil*,

¹¹ Shih G. De Rada, *Opera Omnia*, vol. I, *I canti premilosaici (1833-1835)*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, ediz. Rubbettino, Soveria Mannelli, 2005.

¹² M. Mandalà, *Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës (1822-1837)*, këshilluar në dorëshkrim me pëlqimin e autorit.

¹³ J. De Rada, *Rapsoditë Arbëreshe*, në *Vepra letrare*, vëll. V (përgatitur për botim nga Fiorella de Rosa), Tiranë 2014, f. 294.

¹⁴ G. De Rada, *Rapsodie d'un poema albanese raccolte nelle colonie del napoletano tradotte da Girolamo de Rada e per cura di lui e di Niccolò Jeno de' Coronei ordinate e messe in luce*, Tipografia di Federigo Bencini, Firenze, 1866.

¹⁵ F. Altimari, hyrje në *Canti Premilosaici*, *Opera Omnia*, vol. I, p. 397: *Si è qui risolta l'abbreviazione "Mil" dell'originale in "Miloshini" e non in "Milosao", tendendo conto dell'attestazione nel poema di esame dell'unico caso dell'nome di persona "Miloshini" nell'atto immediatamente precedente, mentre l'altro nome di persona "Millosao" lo troviamo attestato solamente nei canti 25 e 26.*

ose tek emrat e përveçëm që e përmbajnë të njëjtën rrënjë: *Miloš, Milan, Milena, Miloslav, Miljenko e Milenko, Ludmila* dhe shumë të tjerë. Në serbokroatishte bashkëtingëllorja *l* në pozicion fundor është hapur në zanore *o*: *mislao* për *mislal*, *pisao* për *pisal*, *Radoslao* e *Radoslaw* prej *Radoslav* etj. Edhe hipoteza e Arshi Pipës për burimin e emrit vetjak *Rodhavan* nga rrënja *radū*¹⁶, me kuptimin *i zellshëm*, është e dyshimtë, sepse më pranë këtij emri është rrënja sll. *radost - radosti*, prej nga dhe mbiemri *rada* - i gëzuar, që përputhet me mbiemrin e vetë *Radhanjet*, një patronim me përhapje të gjerë jo vetëm tek arbëreshët, por dhe tek arvanitët¹⁷. Pikërisht këtë cilësi, *harenë*, i thekson poeti karakterit të vet në shfaqjen e tij të parë në poemë:

*Zgjou, trim, i agëzuam:
 Ënzot lëreu vërr,
 perëndonjën ilëzit,
 shughen zjarret, derdhet ujit,
 jeta veshet ndër të rea;
 ashtu zëmër lipisjare
 ti të priresh e gharepsur*¹⁸

II.

Studimet që u paraqitën në 200-vjetorin e lindjes së De Radës në njërën anë bënë të ditur një gjendje të re të dijes shqiptare rreth veprës së tij, rreth letërsisë arbëreshe, rreth rolit paraprirës të mendimit kombëtar në botën e italo-shqiptarëve; kurse në anën tjetër u pa qartë se paqartësitë rreth saj ende janë të shumta, duke filluar prej formës së drejtë të emrit të *Millosaut*.

Një prej formave më të hershme të emrit të kryepersonazhit të De Radës është **Milosaat** (*Milosāt*). E përdor vetë De Rada. Në këtë formë, *Milosaat*, regjistrohet botimi i parë i veprës së tij më 1836 në *Biblioteca Nazionale di Napoli*. Nuk është shpjeguar burimi i kësaj forme. Ka shumë të ngjarë që të jetë përfutur në një anë si arkaizëm i të folmeve arbëreshe, në anën tjetër mund të jetë quajtur dhe një prishje e gramatikës prej autorit vetë (*agramatikalitet*). Sipas mendimit tonë, *Milosaat* është një shumës i *Milosa*, përdorur në këtë rast në mënyrë metonimike si emër i autorit në vend të emrit të veprës, me kuptimin *një nga këngët e Millosaut*, kurse forma *Milosaat* me kuptimin *të gjitha këngët e Millosaut*, një shumës kolektiv që është dukuri e gjallë edhe sot në shqip. A ka gjedhe të stabilizuar gjuha shqipe për këtë formë? Shumësi i emrave femërorë me theksim në rrokje të hapur fundore është një gjedhe e tillë. *Milosao*, kuptuar


¹⁶ A. Pipa, *Jeronim De Rada*, cit., f. 51.

¹⁷ M. Rešetar, *Le comunità serbocroate dell'Italia meridionale*, Campobasso 1997, f. 21-22.

¹⁸ G. De Rada, *Vepra letrare*, vol. II, *Këngët e Millosaut - I canti di Milosao*, botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873) përgatitur nga Francesco Altamari, Tiranë 2014, f. 34.

De Rada dhe Millosau: Rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës

si kënga e Millosaut, do ta formonte shumësin në mënyrë krejt korrekte si në botimin e parë të veprës së De Radës: *Millosaat, shumë* (të gjitha) *këngë të Millosaut*. Po nuk mund të përjashtohet dhe mundësia që dyfishimi i zanores *a* të ketë ardhur prej një asimilimi njësoj si te *Stanislao-Stanislaa*.



— 24 —

VIERSH I SHËNËT MILOSAUT

Po tech góra u nanc cam xee:
Se cuventin varessign e me shii
E me diel passign ashtupösht gn ree.

Po m'ish par jetten vaizha e baardh
E gkiacut t' culqam e fanmiir,

Cs per maal, je pa vrsitur at ndeer
Vo dii limüne te m'i vñi ndo door.

1. *Milosaat*, titulli i librit në botimin e vitit 1836, sipas skedimit të *Biblioteca Nazionale di Napoli*.
2. *Milosau*, Napoli 1847, f. 24.

I. Forma agramatikore *Milosaat*

Nr.	Forma e emrit	Nga kush	Në kontekst
1.	Milosaat	Namik Ressuli	<i>Milosaat</i> , pjesë të zgjedhura e të komentuara prej dr. Namik Ressulit, <i>Luarasi</i> , 1938.
2.	Milosaat	Pa autor	<i>Milosaat</i> , Skedë në Biblioteca Nazionale di Napoli, <i>Catalogo per autori e titoli</i> .
3.	Milosaat	Eqrem Çabej	Titull e tekst ¹⁹ .
4.	Milosaat	Skënder Pirro (Sterio Spasse)	<i>Bashkë me komentimet e Namik Ressulit veprës së De Radës, "Milasaat", dhe të Ziaudin Kodrës veprës së Skiroit "Minos", gatuan brumin fillestar për një kritikë të plotë</i>

¹⁹ E. Çabej, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes - romantizmi në Europë lindore e juglindore*, Tiranë 1994, f. 69.

			<i>letraro-artistike të veprave nga ndonjë pëndë kritike e vërtetë</i> ²⁰ .
5.	Milosaat	Kostaq Cipo	<i>Cercheremo da ogni parte per poter trovare il "Milosaat", chiamato anche il "Milosao", romanzo lirico autobiografico di Girolamo de Rada</i> ²¹ .
6.	Milosaat	Athanas Gegaj & Rexhep Krasniqi	<i>They had created schools where Albanian was taught, and two of their people were the first to initiate nationalist trends in Albanian literature, Girolamo De Rada (1814-1903) published in 1836 "Milosaat", a poetic creation</i> ²² .
7.	Milosaat	Aurel Plasari	<i>E kam fjalën për një portë që për letërsinë tonë ka punuar qysh moti: në kuptimin që prej fillimeve të saj letërsia moderne shqipe ka qenë gjithnjë me sytë nga Europa; të themi qysh nga "Milosaat" e De Radës</i> ²³ .
8.	Milosaat	Jusuf Ferizi	Titull e tekst ²⁴ .
9.	Milosaat	Gani Luboteni	<i>Figurat e tij femërore, që nga bujaresha Serafina Topia gjer te vasha fshatare e thjeshtë, te e bija e Kologresë në veprën e rinisë "Milosaat", janë vizatuar mbase më mirë në veprat e tij sesa figurat e burrave</i> ²⁵ .

Në traditën e përshtatjeve prej studiuesve shqiptarë për një gjysmë shekulli u ngulit si forma më e drejtë e emrit të *Milosaat* trajta e interpretuar prej italishtes *Milosao*. Ishin studiuesit arbëreshë Francesco Altimari e Matteo Mandalà ata që, duke përgatitur botimin e plotë të veprave të De Radës, shtruan dhe zgjidhën dhe çështjen e emrit të vërtetë të alter ego-s së poetit, *Milosa*.

²⁰ Sk. Pirro (Sterio Spasse), *Prodhimi letrar në dy vjetët e fundit (1941-1942)*, në *Shkëndija*, viti III, nr. 2, Tiranë, dhjetor 1942, f. 39.

²¹ Shih në sitin: Prof. Kostaq Cipo, *La biblioteca del lavoratore intellettuale*, përgatitur nga Robert Cipo, këshilluar më 6 qershor 2013, ku autori citohet: *Cercheremo da ogni parte per poter trovare il "Milosaat" chiamato anche il "Milosao", romanzo lirico autobiografico di Girolamo de Rada*.

²² A. Gegaj, Rexhep Krasniqi, *Assembly of Captive European Nations - Albania*; University of Texas, New York 1964, f. 20.

²³ A. Plasari, *Nga cila portë hyjmë: dy paradigma*, gazeta 55, 9 qershor 2004.

²⁴ J. Ferizi, *Ndikimi i jetës fshatare dhe vetë jeta e fshatit në "Milosaat" e De Radës*, në *Përparimi*, nr. 9, 1962.

²⁵ G. Luboteni, *Ndihmesa e E. Çabejt në prezantimin e romanticizmit në Evropën Lindore e Juglindore dhe në letërsinë shqiptare*, këshilluar në sitin *Zemra Shqiptare*, 19 shtator 2008.

De Rada dhe Millosau: Rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës

Pikërisht në këtë formë, *Milosa*, e përdor vetë De Rada në variantin shqip, botimi i dytë (1847). Sa i takon vlerës fonologjike të grafemës *l* në letërsinë arbëreshe, për këtë përgjigjen e ka dhënë Matteo Mandalà, duke shtruar pyetjen Bala apo Balla²⁶, dhe duke e zgjidhur atë në favor të së dytës, duke i dhënë asaj vlerën e fonemës *ll* të shqipes. Kemi arsye të besojnë në këtë interpretim të tij, edhe pse dihet që në të folmet arbëreshe, nën ndikimin e greqishtes kishtarë, ka dhe një *l*-të ndërmjetme si në greqishtet *καλογρέζα* e *κολοφών*; siç shmanget disi drejt *χ*-së së greqishtes edhe *h*-ja ndërzanore e arbëreshëve.

F. Altimari shkruan për këtë: *Preferojmë të përdorim, në respekt të vullnetit të Autorit, që na rezultojnë qartas qysh prej analizës së dorëshkrimeve të para të tij arbërisht, trajtat Millosa - Millosau, lakuar sipas emrave të gjinisë mashkullore me zanore fundore të theksuar dhe jo Milosao - Milosaoja, të përshtatura shqip sipas lakimit të emrave femërorë që dalin në -o duke u nisur nga trajta e italishtes “Milosao” dhe tashmë të ngulitura në traditën shkrimore shqiptare. Duhet saktësuar se në traditën studimore shqiptare trajta “Millosau” është ajo më e hershme, edhe pse shkruar me “l” - Milosau - për shkak të varësisë së saj nga italishtja e shkruar dhe jo nga arbërishtja që kërkonte përshtatjen e emrit me dyshkronjën “ll”²⁷.*

II. Format *Milosa-Milosau-Millosau*²⁸

Forma e emrit	Nga kush	Në kontekst
Millosa	Girolamo de Rada	<i>Kūr po lēn shpīn e t’emtet zoti ai Millosā dhe vjen; e te gjīr’i zōnjes s’ēm fjet e kā mälle ghadhjār</i> ²⁹ .

²⁶ M. Mandalà, *Për botimin kritik të Kënkës së sprasëme të Ballës: shënime filologjike paraprake*, në *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, bot. Naimi, Tiranë 2012, f. 93-147.

²⁷ G. De Rada, *Vepra letrare*, vol. I, *Këngët para Millosaut - I canti premilosaoici*, botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873) përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë 2014, f. 11.

²⁸ Krhs dhe F. Altimari, vep. cit., f. 11: “*Milosau*” është përdorur në përshtatjen e poemës së De Radës në shqipen e sotme prej studiuesve Jup Kastrati (Tiranë 1956), Din Mehmeti (Beograd 1965), Andrea Varfi (Tiranë 1974, Tiranë 1976, Prishtinë 2002), ndërsa trajta më e përhapur sot ndër shqiptarët “*Milosao*” u standardizua nga Dhimitër S. Shuteriqi (Tiranë 1964, Tiranë 1976, Prishtinë 1980, Tiranë 1987). Edhe në botimin e fundit të veprave të De Radës të sapocituara, të përgatitura nga J. Kastrati, K. Kodra dhe P. Jorgoni, vazhdohet të ndiqet “*versioni*” i Shuteriqit dhe jo ai i Kastratit, megjithëse studiuesi shkodran ishte ndër përgatitësit e botimit. Sipas kësaj “*tradite*” të nisur nga Dh. S. Shuteriqi, vazhduan të përdorin trajtën “*Milosao*” dhe jo “*Millosau*” edhe autorë të tjerë në botimet e mëpasme, si P. Çabej (Tiranë 1999), Gj. Zheji (Tiranë 2009), A. Toli (Tiranë 2009).

Milosau	Jup Kastrati	Titull e tekst ³⁰ .
Milosau	Jup Kastrati	Titull e tekst ³¹ .
Milosau	Dh. S. Shuteriqi	Titull e tekst ³² .
Milosau	Andrea Varfi	Titull e tekst ³³ .
Millosau	Francesco Altimari	<i>Canti Premilosaici - Këngët para Millosaut</i> , vëll. I, ediz. Rubbettino 2005 ³⁴ .
Millosau	Francesco Altimari	<i>Canti di Milosao - Këngët e Millosaut</i> , vëll. II, ediz. Rubbettino 2005 ³⁵ .
Millosau	Matteo Mandalà	<i>De Rada i kaloj turbullimet e para rinore që e pengonin të botonte "Këngët e Millosaut" falë nxitjes dhe këmbënguljes së Biderës</i> ³⁶ .
Millosau	Vincenzo Belmonte (a cura di)	Ndaj ju ngrë po i biri [i] Fughes: <i>Millosau: Këtu, zot-e i madheshm, Nganjë vënd' e mër çe mbân</i> ³⁷ .
Milosau	Michelangelo La Luna (a cura di)	<i>"Këngët e Milosaut" të Jeronim De Radës: zanafilla dhe struktura</i> , tesi di laurea, Università della Calabria, 1990 ³⁸ .
Milosau	Maria Vittoria Scalercio	<i>"Milosau" i Jeronim De Radës: analiza, transkrip-timi dhe treguesi leksikor në botimin e parë (1836)</i> , tesi di laurea, Università della Calabria, 1990 ³⁹ .
Milosau	Irene de Rose	<i>"Këngët e Milosaut" të Jeronim De Radës botimi i tretë (1873)</i> , botim kritik dhe përkime; tesi di laurea, Università della Calabria, 1990 ⁴⁰ .
Milosau	Lina Antonella Gallo	<i>"Këngët e Milosaut" (1847) të J. De Rada; transkriptimi, përkthimi, frekuenca dhe leksiku</i> ; tesi di laurea, Università della Calabria, 1990 ⁴¹ .

²⁹ G. De Rada, *Milosaat*, botim dytë, 1847, f. 106.

³⁰ J. Kastrati, Jeronim de Rada, *Kangë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës*, Beograd 1965.

³¹ J. Kastrati, N. Tomaseo, *mendime mbi "Milosaun"*, në *Drita*, 6 dhjetor 1964.

³² Dh. S. Shuteriqi, Jeronim de Rada, *Këngë të Milosaut*, në *Nëntori*, nr. 12, 1954.

³³ A. Varfi, *Një përshtatje e re e "Milosaut" të De Radës*, në *Zëri i popullit*, 13 mars 1965.

³⁴ F. Altimari (a cura di), Girolamo de Rada, *Opera Omnia*, vol. I, ediz. Rubbettino, 2005.

³⁵ F. Altimari (a cura di), Girolamo de Rada, *Opera Omnia*, vol. II, ediz. Rubbettino, 2005.

³⁶ M. Mandalà, *Jeronim de Rada dhe arbëreshët e Sicilisë*, në *Milosao*, 27 tetor 2014.

³⁷ V. Belmonte (a cura di), *Opera Omnia*, vol. VI, *Scanderbeg sventurato*, f. 190, 216, 2005.

³⁸ Në sitin e Università della Calabria, www.albanologia.unical.it/tesi_shqip.htm

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

De Rada dhe Millosau: Rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës

Milosau	Institut des Etudes Balcaniques	<i>Jeronim de Rada (1814-1903), plaku i nderuar i kolonisë shqiptare në Itali botoi vepra romantike, në mesin e të cilave edhe "Milosau"</i> ⁴² .
Milosau	Mihal Jano	<i>Emri "Milosau" nuk është një sajësë, por është një emër simbolik, që të kujton luftëtarin trim të Skutarit që bie për atdhe. Emri i Milosaut vjen nga emërtimi i hershëm i qendrës së Skuterës, që quhej dikur Milos (Ana Komneni)</i> ⁴³ .

Koherent në këtë arsyetim, Francesco Altimari, ndërsa qorton formën e ngulitur prej një *interpretatio italica* në botimin shqip të veprës së De Radës, në botimin italisht ruan formën që përdor vetë autori: *Milosao* (por të transliteruar me *l* të dyfishtë).

III.

Rada apo Radha?

Siç patëm rast ta përmendim, edhe patronimi *Rada* nuk ka ende një formë të njësuar në përdorim në botime e në studime. Arsyeja themelore është ekzistenca e këtij patronimi, ashtu si dhe e emrit, në një larmi variantesh, që kanë si shkak burimin e ndryshëm të shqiptimit dhe shkrimit: arbërisht e italisht më së pari, por nuk mund të shpërfilllet gjithashtu fakti që fonetika e greqishtes, veçmas vlera fonologjike e grafemës *δ*, si tek *κώδικα, δασκάλα, ειδωλ*, mund të ketë pasur ndikimin e saj anësor. Poeti vetë, në artikujt botuar në arbërisht në *Fiamuri Arbërit*, rregullisht përdor nyjen e vjetër aristokratike *i* të shqipes (njësoj si tek *i Gjomark, i Hot*) në vend të nyjes së fisnikërisë europiane *de: Rodrigu i Radanjet, Sepëse Radhanjet, Giusepp' i Radhanjet, kroi i Radhanjet*. Ndërsa mbiemrin vetë e shkruan me *dh* në arbërisht e me *d* në italisht. Në *Fiamuri Arbërit* në ndonjë rast nuk përdor as nyjen shqipe të fisnikërisë, as atë të Italisë, por shkurtimin *cav.*, për *cavaliere*. Të njëjtën formë përdor dhe për Gavril Darën (cavaliere).

Në poezinë që Naimi, Samiu dhe Jani Vreto i kushtuan Zef de Radës *in memoriam*, pak kohë pas vdekjes, në formën e epitafit për të dhe të ngushëllimit për të atin, përdoren format *Radha, Radhësë, Radhenjet: Bir i Radhësë, Josif dhe Vaji mbi shtëpinë e Radhanjet*⁴⁴.

⁴² AA VV, *Libri për Ballkaninë*, vol. I, Beograd 1936, f. 346.

⁴³ M. Jano, *200-vjetori i Jeronim de Radës*, në *Zemra Shqiptare*, 5 tetor 2014.

⁴⁴ Poezia, e cila u shkrua në Konstantinopol, më 13 kallënduar 1884, nga ndonjë studiues është konsideruar elegji e shkruar nga Naim Frashëri, megjithëse në tekst autorësia identifikohet me tre emra: Naimi - në vetë të tretë - Samiu dhe Vreto (shih: *Dy vëllezërit e romantizmit shqiptar: elegjia e panjohur e Naimit për djalin e De Radës*, në *Koha*, 23 dhjetor 2015; pa autor, por botuar në të përditshme të tjera me emrin e Moikom Zeqos: Poezia ka këtë përmbajtje:

**De Rada, De Radha, Girolamo i Ràdhanjet
apo Jeronim i Radanjvet?**

Ràdha në kontekst shqip në Fiamuri Arbërit	Po aty, në përkthimin italisht
Di vëlëszer Corriàdhi ncà Shën Remi ndë dheet Gènuës, Udhìs Pàncari Benapiessëm Shen Mìter e Trapeszes madhe të Cosenzes, Albèrt i Markjanonet cà Shen Mitëri, Miccantòn Palazzi cà Stregari, e ncà Makji Rodrigu i Ràdhaniet , i biri i Diretturit <i>Fiamurit</i> .	... e da Makji Rodrigo de Rada , figlio del Direttore del <i>Fiamuri</i> ⁴⁵ .
Ncà cartë Sepësë Ràdanjet	Dalle carte di Giuseppe de Rada ⁴⁶ .
Vaij mbi Sepën e Ràdhanjet ⁴⁷	
Diè vëdikje pas ljenchim të gchiatt, chè duròì mosse štùara, Giusepp' i Ràdhanjet , i biri Drëkëtàrit <i>Fiamurit</i> .	Ieri, dopo lunga malattia, che Egli sostenne sempre in piedi, morì Giuseppe De Rada , figlio di Direttore della <i>Bandiera</i> ⁴⁸ .
Duam të štomi edhé se ndë špie të Derviš Islia beut caa në burgh i cilji, si cë thoon pljëkjkt, fkjinerón nëën dheë me cròin e Rhádhenjszit . ⁴⁹	

Vllastar i lashtë i Shqipërisë,
Në dhethit të Italisë,
Bir i Radhësë, Josif,
Jetën e rith' e ndërrove,
Tët atë fort e helmove
Edhe këdo që të njih,
Shqipëria, kujt mirë i doje,
Në gjuhët tënde e shqip shkroje,
Gjithëmonë të kujton,
Mbi varr të shkruan këto fjalë:

Josif, o shpirt, o djalë!
Vëdiqe, por emri yt rron,
Ndaj të Dhimitrit Kamardë,
Pasëqyrë për djelmënitë.
Vëlla Dhimitër Kamarda,
Prej tij ne prisnimë letrë,
Po të të ardhëkej radha,
Shkuakësh në jetën tjetër.
Vretoja dhe Niami
Me Saminë të vëllanë
Brenda ndë zemërë ju kanë.

⁴⁵ *Fiamuri Arbërit*, nëntor 1885, f. IV.

⁴⁶ *Fiamuri Arbërit*, prill 1884, f. V.

⁴⁷ *Fiamuri Arbërit*, shk urt 1884, f. VII.

⁴⁸ *Fiamuri Arbërit*, dhjetor 1883, f. I.

⁴⁹ *Fiamuri Arbërit*, korrik 1884, f. VII, *Topografia e Corçës*.

Dy llipusha e Avatity. Epistulae, duae Francisci Avati (sine dato 1800) repperi domi Radhesy . (kopjuar në Danimarkë), 6 f. ⁵⁰	
Kujtime për Jeronim de Radën .	Memorie di Jeronim Radanjvet ⁵¹

Më e ndërlikuar ende paraqitet variantistika e emrit parësor të poetit, variantistikë që ka pasur dominancat e veta nga njëra periudhë në tjetrën, por ende mbetet aq laragane në tërësinë e vet, sa mund të thuhet se ekziston një anarki e vërtetë.



Gerolamo dhe Girolamo nga vetë De Rada.

De Rada, tri prej veprave të tij: *Poesie Albanesi* (Napoli 1898), *Caratteri della lingua albanese* (Catanzaro 1899) dhe *Testamento politico* (Catanzaro 1902) i nënshkruan në formën Gerolamo de Rada, kurse veprat e tjera i ka nënshkruar në formën *Girolamo de Rada*. Në Fiamuri Arbërit, kur nënshkruan si autor, përdor formën *Girolamo*, kurse kur nënshkruan si drejtor, përdor formën *Gerolamo de Rada*. Në të dyja rastet, bie në sy se formën Gerolamo poeti e ka përdorur kryesisht në gjysmën e dytë të jetës.


Nëse në rastin e dyfishësisë së formës së emrit të përdorur tek *Fiamuri Arbërit* mund të ketë një shpjegim, për shembull me prishjen e monotonisë së lexuesit, duke përdalluar De Radën autor prej De Radës botues, është vështirë të gjendet

⁵⁰ Përshkrimi i dokumentit sipas shenjimit në ballinë të dosjes në *Kongelige Bibliotek, Denmark*.

⁵¹ Si në sitin *Non omnis moriar*, të bashkësisë së *Makjit arbëresh*, shtator 2011.

ndonjë shpjegim bindës për rastin e parë, të variantistikës së emrin e autorit në veprat e botuara, dukuri e tri dekadave të fundme të jetës së tij.

Kjo çështje ka dhe anën tjetër, si e kanë përdorur të tjerët emrin e De Radës. Forma më e çuditshme është *Dçelorm' i Ràdhanjve* dhe i takon Namik Ressulit, në *Shkrimtarë shqiptarë*, I, 1941: *Jeronim de Rada, ase, si e quanin bashkatdhetarët e tij "Dçelorm' i Radhanjve", poeti më i math i Arbëreshëve të përtej Adriatikut, lindi në Makji të Kalabrisë më 19 të nëntorit 1814*⁵². Duke qenë se Ressuli kishte bërë dhe një përshtatje të *Milosaa*-ve më herët (1938), kishte formim klasik filologjik dhe e njihte botën arbëreshe, mbetet të besohet se nuk kemi të bëjmë me ndonjë lajthitje teknike apo gjuhësore, por ndoshta me parapëlqimin e ndonjë prej formave të shumta dialektore të arbërishtes heteroglotike, ose, ndoshta, kjo formë përfaqëson një kontaminim të varianteve arbërisht, italisht e shqip. Nuk shfaqet në asnjë rast studimi apo botimi tjetër.



Hieronimus, emri i De Radës në regjistrin kishtar

(Në bardhësinë e majtë: Girolamo Rada

Në tekst: *nomen Hieronymus*)

Dokumenti ruhet në formën e fotokopjes në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Format kryesore të emrit të De Radës janë këto dhe po i rendisim më poshtë në kronologji e me referencat dhe kontekstet e përdorimit: *Jerolam e Jerollam*, *Geronim e Geronimo*, *Hjerollam*, *Hjerolim*, *Hieronym*, *Hieronimus* e *Hieronimi*.

Në gjysmën e parë të shekullit XX u përgjithësua forma *Jerolam - Jerollam - Hjerollam*. Forma *Hieronim* e *Hieronym* u përdor kryesisht prej qarkut veriperëndimor të Shkodrës (Filip Fishta, Filip Ndocaj, Kolë Ashta). Kostaq

⁵² N. Ressuli, vep. cit., f. 252.

Cipo preferonte formën *Gjirolam*, e afërt me atë të Ressulit që e përmendëm, nga Luigj Gurakuqi. Format *Hieronyme*, *Hieronymi*, *Hieronymus*, që përdorën Luigj Gurakuqi e Arshi Pipa, janë forma të së njëjtës përzgjedhjeje dhe paraprihen prej Theophilus Stier, i cili përktheu në gjermanisht *L'Albania dal 1460 al 1485 (Rrëfimet e Arbërit)*. Dihet se forma referenciale e emrit të De Radës është ajo e emrit të Shën Jeronimit, *Sanctus Hieronymus*, protektorit të përkthyesve dhe atit të hermeneutikës. Ai u lind në një familje me besim të fortë në Krishtin dhe nuk ishte e mundur të mbante një emër laik. Nuk e dimë a ka lidhje kalendarike apo të ditës së emrit lindja e De Radës me Shën Jeronimin.


**HIERONYMI DE RADA CARMINA ITALOALBANICA QUINQUE
TRANSCRIPTIT VERTIT GLOSSARIO NOTISQUE INSTRUIT**

THEOPHILUS STIER.

**BRUNSVIGAE
APUD C. A. SCHWETSCHKE ET FILIUM.
(M. BRUHN.)
1856.**

***L'Albania dal 1460 al 1485: forma Hieronymi de Rada e emrit të De Radës në
frontespicin e përkthimit gjermanisht Carmina Italoalbanica,
nga Theophilus Stier.***

Tashmë kjo formë është pranuar nga të gjithë, duke përfshirë arbëreshët vetë, dhe nuk ka vend për të diskutuar për normësim, sido që nuk kemi siguri se autori do ta pëlqente këtë formë apo jo. Rilindësit, sa që gjallë (Mitko, Konica), ia shkruanin emrin ashtu siç e shkruante ai vetë. Në anën tjetër, forma e ngulitur tashmë thuhet i ka shkëputur (së paku nuk t'i kujton) lidhjet me shenjtorin.



Një formë krejt e panjohur e emrit të De Radës, *Geralimo*, në certifikatën e lindjes (ruhet në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë)

Variante të emrit të De Radës në studime e botime:

Forma e emrit	Nga kush	Konteksti dhe ku
Girolamo de Rada	Autori vetë	
Girolamo	Asdreni	<i>Girolamo de Radës</i> , në <i>Rreze djelli</i> , Bukuresht

De Rada dhe Millosau: Rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës

de Rada		1904.
Girolamo de Rada	Faik Konica	<i>Shqipja e Girolamo de Radës</i> , në <i>Albania</i> nr. 8, 1904, f. 146-147.
Girolamo de Rada	Izet Bebeziqi	<i>Girolamo de Rada</i> , në <i>Djalëria</i> , Vjenë, korrik 1927. <i>Girolamo de Rada dhe feja</i> , në <i>Shqipëria e Re</i> , 9 mars 1930. <i>Girolamo de Rada</i> , në <i>Shekulli XX</i> , Tiranë, janar 1934.
Gerolamo de Rada	Comune di Cosenza	Via <i>Gerolamo de Rada</i> , 87100, Cosenza (Cz).
Gerolamo de Rada	Comune di Potenza	Largo <i>Gerolamo de Rada</i> , 850 20, Maschito (Pz).
Gerolamo de Rada	Vincenzino Ducas Angeli Vaccaro	<i>Gerolamo De Rada fra letteratura e rivoluzione</i> , në <i>Nuovo monitore napoletano</i> , Napoli 2013.
Gerolamo de Rada	Francesco Marchianò	<i>Relazioni fra Gerolamo de Rada e Spezzano Albanese</i> , ediz. <i>Arbitalia</i> , 2013.
Gerolamo de Rada	Anthony Klançar	<i>Modern Albanian Literature</i> , në <i>Books Abroad</i> , vol. nr. 16, 1942.
Gerolamo de Rada	I. Aliaj	<i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Laboremus</i> , vëll. VIII, nr. 15, Tiranë 15 qershor 1932.
Gerolamo de Rada	Kostaq Cipo	<i>Biblioteka e një punëtori mendor</i> , në <i>Gazeta e Re</i> , 3 mars 1923.
Gerolamo de Rada	GENNARO DE CICCIO	<i>Il "Milosao" di Gerolamo De Rada - Antologia</i> , në <i>Il Coscile</i> 2004.
Gerolamo de Rada	COMUNE CERZETO	<i>Il ruolo e l'impeto della letteratura arbëreshe nella storia dell'Indipendenza Albanese</i> , Cerzeto 2013.
Gerolamo de Rada	Ettore Paratore	<i>L'umanità di Gerolamo de Rada attraverso testi recentemente scoperti</i> , në <i>Shêjzat</i> , nr. 7-8-9-10, 1964.
Gerolamo de Rada	Emilia Giglio	<i>Realtà umana e sguardo interiore di Gerolamo de Rada</i> ; në <i>Shêjzat</i> , 7-8-9-10, 1964.
Gerolamo de Rada	Piero Tamburi	<i>Milosao e Serafina Thopia - figure centrali dell'opera di Gerolamo de Rada</i> , në <i>Shêjzat</i> , 7-8-9-10, 1964.
Gerolamo de Rada	Sterio Spasse	<i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Normalisti</i> , vëll. 2-3, Elbasan, shkurt-mars 1933.
Gerolamo De Rada	Pa autor	<i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Përparimi</i> , nr. 5, 1917; <i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Afërimi</i> , 19 prill 1923 (New York); <i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Shqipëria e Re</i> , 30 qershor 1923 (Costanze); bis, nr.

		VIII, 1926; bis, 28 nëntor 1926; bis, 20 korrik 1932; <i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Gazeta e Tiranës</i> , 4 maj 1932; <i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Gazeta e Korçës</i> , 1938/20; <i>Gerolamo de Rada</i> , në <i>Gazeta shqiptare</i> , 13 korrik 1932 (Bari).
Gjirolam de Rada	Kostaq Cipo (Scampensis)	<i>Gjirolam de Rada</i> , në <i>Kuvendi</i> , Romë 6 shtator 1918.
Jerolam de Rada	Llambi Gjergu	<i>Veprat e Jerolam de Radës</i> , në <i>Drita</i> (Gjirokastër), 22 shkurt 1923, 14 mars 1923; <i>Jerolam de Radës</i> , në <i>Kombi në rrezik</i> (Boston), 21 korrik 1923; <i>Jerolam de Radës</i> , në <i>Afërimi</i> (New York), nr. 8; <i>Jerolam de Rada</i> , në <i>Dielli</i> (Boston), 19 prill 1929.
Jerolam de Rada	Kastri (pseud.)	<i>Jerolam de Rada (1814-1903)</i> , në <i>Demokratia</i> , Gjirokastër 1 mars 1933.
Jerollam de Rada	Zijaudin Kodra	<i>Jerollam de Rada, një nga ma të vjetrit idealist dhe një nga me të parët shkrimtarë të mëdhenj shqiptarë</i> , në <i>Besa</i> (Tiranë), nr. III, 1934; <i>Autobiologjija e Jerollam de Radës</i> , në <i>Besa</i> , nr. III, 1934 (7 mars).
Geronimo de Rada	Balázs Trencsényi, Michal Kopeček (edit.)	Discourses of Collective Identity in Central and Southeast Europe, vol. II, National Romanticism - The Formation of National Movements, CEU Press, 2007.
Geronimo de Rada	Pascal Mougin, Karen Haddad-Wotlig (edit.)	Dictionnaire mondial des littératures, edit. Larousse, Paris 2002.
Hjeronim de Rada	Filip Ndocaj	Letratyra e jonë: problem që do shvillue - shfaqje e mendësis s'onë, në <i>Fryma</i> , nr. 3, 1944, f. 116.
Hieronim de Rada	Sezai Kemal / Nota	<i>Hieronim de Rada</i> , në <i>Politika</i> (Vlorë), 6 nëntor 1924.
Hjeronym de Rada	Filip Fishta	Luigj Gurakuqi - njeriu i shtetit e shkrimtari, në <i>Hylli i Dritës</i> , mars 1944, f. 57.
Hjeronym de Rada	Kolë Ashta	Shenjime rreth epikës së Hjeronym de Radës, në <i>Tomorri i vogël</i> , Tiranë 1 mars 1943; Tue përkujtue katërdhjet-vjetorin e vdekjes së Hjeronym de Radës, ndihmestari i Rilindjes letrare e kombëtare, në <i>Shkëndija</i> , Tiranë 1943, viti III, nr. 4, f. 32-34; Hjeronym de Rada, në <i>Shkëndija</i> , 13 mars 1943.

De Rada dhe Millosau: Rreth varianteve të emrit të autorit dhe të veprës

Hieronyme de Rada	Luigj Gurakuqi	Disa viersha të Hieronyme de Radës me shënime, në Albania (London), nr. IX, 1905.
Hieronymi de Rada	THEOPHILUS STIER	Hieronymi de Rada, Carmina italoalbanica quinque transcripsit vertit glossario notisque instruxit, Brunsvigae (Braunschweig) 1856.
Hieronymus de Rada	Arshi Pipa	<i>Hieronymus de Rada</i> , vol. II i <i>Trilogia Albanica</i> , volume 18 i <i>Albanische Forschungen</i> , edit. R. Trofenik, Muenchen 1978.

Ky është vetëm njëri nga problemet. Një diskutim formal ekziston edhe për mënyrën si është shkruar nyja aristikratike midis emrit dhe mbiemrit. Në botimin e plotë të veprës së poetit u pranua forma *De*, në çfarëdo pozicioni, ndryshe prej një tradite tjetër, që të shkruhej me gërmë të madhe vetëm kur paraprinte mbiemrin pa emrin, që duket të ketë qenë më e sakta. Së paku në traditën e vendeve që e ruajnë edhe sot këtë nyje, në pozicion të ndërmjetëm shkruhet me të vogël (*de* e *du* në frëngjisht, *von* në gjermanisht, *van* e *der* në hollandisht, *de* në italisht etj.). Vepra e De Radës nuk mund të kuptohet pa depërtuar në kuptimin e çdo fjale e forme, qoftë emërtimeve të përveçme, qoftë kategorish të përgjithshme. Këtu poshtë po paraqesim vetëm kuptimin sinonimik atdhe e atdhetar në përdorimin e fjalëve katund e katundar në ligjërimin e tij.

BIBLIOGRAFI

- A. Di Lellio, *The Battle of Kosovo 1389: An Albanian Epic*, edit. I. B. Tauris, London 2009.
- A. Pipa, *Hieronymus De Rada - Jeronim De Rada*, botimet Princi, Tiranë 2013.
- F. Altimari, Hyrje në *Canti Premilosaici*, *Opera Omnia*, vol. I, ediz. Rubbettino, 2005.
- G. De Rada, *Opera Omnia*, vol. I, *I canti premilosaici (1833-1835)*, edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari, ediz. Rubbettino, Soveria Mannelli, 2005.
- G. De Rada, *Rapsodie d'un poema albanese raccolte nelle colonie del napoletano tradotte da Girolamo de Rada e per cura di lui e di Niccolò Jeno de' Coronei ordinate e messe in luce*, Tipografia di Federigo Bencini, Firenze 1866.
- J. De Rada, *Rapsoditë shqiptare*, në *Vepra letrare*, vëll. V (përgatiti për botim Fiorella de Rosa), Tiranë 2014.
- J. De Rada, *Vepra letrare*, vëllimi II, *Këngët e Millosaut/ I Canti di Milosao*, botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873), përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë 2014.
- J. De Rada, *Vepra letrare*, vol. I, *Këngët para Millosaut - I canti premilosaici*, botim kritik i tri varianteve (1836, 1847, 1873) përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë 2014.
- K. Dervishi, *Kujtimet dhe përshtypjet e Milosao Jeliçit për Elez Isufin: artikull i gazetarit jugosllav i botuar në "Politika" të Beogradit*, në të përditsh. 55, 20 tetor 2004.
- M. Mandalà, *Mbi formimin rinor të Jeronim De Radës (1822-1837)*, në *Jeronim de Rada (1814-2014)*, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2015.

SHABAN SINANI

- M. Mandalà, *Për botimin kritik të Kënkës së sprasëme të Ballës: shënime filologjike paraprake*, në *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, bot. Naimi, Tiranë 2012.
- M. Rešetar, *Le comunità serbocroate dell'Italia meridionale*, Campobasso 1997.
- M. Zeqo, *De Rada: rishpikja e Arbërisë - sprovë kritike për një lexim të ri*, bot. Erik, Tiranë 2014.
- N. Ressuli, *Shkrimtarë shqiptarë*, vëll. I, Tiranë 1941.
- Sh. Sinani, *Botë arbërore veriore në letërsinë arbëreshe: rasti i patronimeve*, në “Midis dy Rilindjesh”, botim i Universitetit të Elbasanit, Tiranë 2010.